



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

Tiranë, më 12.09.2019

Dokument Parlamentar

RAPORT
PËR SHQYRTIMIN E DEKRETIT TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS SH.T.Z.ILIR
META, ME NR.11256, DATË 08.08.2019, “PËR KTHIMIN PËR RISHQYRTIM NË
KUVEND TË LIGJIT NR.53/2019,“PËR AKADEMINË E SHKENCAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Hyrje

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik mbështetur në nenet 81 dhe 93 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neneve 18, 29, 34, 36, 38 dhe 70 të Rregullores së Kuvendit, në cilësinë e komisionit përgjegjës, në mbledhjen e datës 11 shtator 2019 mori në shqyrtim dekretin e Presidentit të Republikës Sh.T.Z. Ilir Meta, me nr.11256, datë 08.08.2019, “Për kthimin për rishqyrtim në Kuvend të ligjit nr.53/2019,“Për Akademinë e Shkencave të Republikës së Shqipërisë”.

Relator për shqyrtimin e këtij dekreti Komisioni caktoi deputetin Ismet Beqiraj.

Gjatë diskutimit të dekretit ishin të pranishëm: znj.Krisilda Fana, drejtore e Drejtorisë Juridike dhe Sigurisë në Presidencë; z. Vaso Tole, akademik; z. Erzen Tola, drejtor i Përgjithshëm, Drejtoria e Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit në Kuadrin Rregullator në MASR.

I.BAZA KUSHTETUESE E DEKRETIT

Dekreti i paraqitur për shqyrtim mbështetet në nenin 85, pika 1, dhe nenin 93 të Kushtetutës.

II. DISKUTIMI NË KOMISION

Fillimisht, në Komision në mënyrë të përmbledhur paraqiti pikat kryesore të dekretit dhe dha shpjegime znj. Krisilda Fana, drejtore e Drejtorisë Juridike dhe Sigurisë në Presidencë, e cila në mes të tjerash, theksoi se:

Presidenti i Republikës shqyrtoi ligjin nr. 53/2019, duke iu referuar përmbajtjes së aktit të dërguar për dekretim dhe shpallje, praktikës parlamentare të ndjekur për këtë qëllim, duke vlerësuar përputhshmërinë e këtij ligji me parimet dhe parashikimet kushtetuese, legjislacionin aktual në fuqi, si dhe ligjin “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”.

Në përfundim të shqyrtimit të këtij ligji, Presidenti i Republikës ka arritur në përfundimin se ligji nr.53/2019 "Për Akademinë e Shkencave të Republikës së Shqipërisë", bie ndesh me parashikimet e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; cenon autonominë e institucioneve të arsimit të lartë, cenon kompetencat e Presidentit të Republikës dhe nuk është në harmoni me kuadrin ligjor ekzistues të Republikës së Shqipërisë.

Presidenti i Shqipërisë konstaton se: Parashikimet e pikës 1 të nenit 3 të ligjit nr. 53/2019, nuk janë në harmoni me dispozitat e ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë". Në ligjin nr. 53/2019 parashikohet se Akademisë së Shkencave i jepet një status më i lartë në hierarkinë e kërkimit shkencor. Kjo dispozitë është pothuajse në të njëjtën frymë me parashikimet e ligjit nr. 80/2015, por nëse krahasojmë pikën 1 të nenit 3 me pikën 6 të nenit 9, të ligjit nr. 53/2019, duket qartë se Akademisë së Shkencave dhe anëtarëve të Asamblesë së saj u jepet një rol jo vetëm koordinues, por dhe mbikëqyrës ndaj veprimtarisë shkencore të institucioneve të arsimit të lartë.

Znj. Krisilda Fana, drejtoreshë e Drejtorisë Juridike dhe Sigurisë në Presidencë njëkohësisht u ndal në çështje të tjera të këtij dekreti, që lidhen me rolin dhe funksionin e Akademisë, si: strategjitë dhe politikat për përdorimin e njësuar të gjuhës shqipe zyrtare, për botimin dhe shpërndarjen e standardeve të reja ndërkombëtare për kërkimin shkencor dhe inovacionet, kërkimet shkencore të doktoratës, statusi i anëtarit të jashtëm, ndalesat dhe papajtueshmëria në lidhje me moshën e përfitimit të titujve “Akademik i asociuar” dhe “Akademik”, mbi ngritjen dhe funksionimin e njësive të kërkim-studimit dhe çështjet që lidhen me dekretimin e Kryetarit të Akademisë së Shkencave.

Zv/Kryetarja e Komisionit, Milva Ekonomi, kërkoi që të vlerësohet puna që bëri komisioni për përmirësimin e legjislacionit kombëtar në fushën e përgjegjësisë së komisionit, duke ftuar sipas nevojës eksperit që vijnë nga bota akademike dhe shoqëria civile etj..

Relatori, deputeti Ismet Beqiraj, vlerësoi ligjin e miratuar për Akademinë e Shkencave dhe u ndal gjërësisht në argumentat që hedhin poshtë çështjet e shtruara në dekretin e Presidentit të Republikës. Deputeti Ismet Beqiraj gjatë diskutimit të tij, në mes të tjerash, theksoi:

Ligji i ri i Akademisë së Shkencave synon të sjellë shkencën në politikë dhe jo politikën në shkencë.

Ky ligj është produkt i diskutimit të gjerë dhe të gjatë në kohë dhe në hapësirë, brenda dhe jashtë vendit, në institucione kërkimore shkencore, të cilat kanë dhënë çertifikimin e standardit europian, siç është ALLEA-s (*All European Academies*) dhe Akademia Leopoldina.

Deputeti vlerësoi ekspertizën e gjatë që është bërë nen për nen dhe germë për germë prej këtyre akademive të shquara, para se të miratohej ligji.

Po kështu, deputeti vuri në dukje rolin që ka Akademia e Shkencave në kërkimin shkencor dhe promovimin e shkencëtarëve të rinj në tëra nivelet, duke u ndalur në faktin se kërkimin shkencor nuk e kanë monopol vetëm institucionet e arsimit të lartë publik, por edhe ato jopublik, si dhe institucionet e tjera të prodhimit e kërkimit, individë të veçantë etj..

“Institucionet e arsimit të lartë janë “ara pjellore”, që furnizojnë vazhdimisht Akademinë”, ka thënë Akademik Nexhat Daci, Kryetar i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës, nënvizoi zoti Beqiraj.

Në vijim, mbështetur në nenet dhe pikat përkatëse të legjislacionit, deputeti vuri në dukje se: Kërkimi shkencor zhvillohet edhe në institucione të tjera, veprimtaria e të cilave rregullohet me ligj. Gjithashtu, nuk mund të përjashtohet roli “ombrellë” për bashkëpunim i Akademisë së Shkencave me të gjithë institucionet shkencore dhe institucionet e arsimit të lartë.

Me nenin 6, pika 2, e ligjit të miratuar, Akademia e Shkencave i “hap të gjitha dyert” për të marrë pjesë edhe përfaqësuesit e institucioneve të arsimit të lartë e kërkimit shkencor, në procedurat dhe kriteret e përzgjedhjes të kandidatëve për anëtar asambleje.

Nëpërmjet dispozitave (neni 18, pika 2, dhe neni 21, pika 2) të ligjit 53/2019 “Për Akademinë e Shkencave në RSH”, një nga risitë e mëdha të këtij ligji, thellohet më tej bashkëpunimi dhe hapja e Akademisë së Shkencave, lidhur me përbërjen e komisioneve, përveç akademikëve, edhe përfaqësues të institucioneve të qendrave të kërkimit shkencor dhe të arsimit të lartë, dhe hartimit dhe miratimit të programit të Akademisë, duke krijuar ligjërisht ura bashkëpunimi të fuqishme. Ky bashkëpunim është një oksigjen për vetë zhvillimin e shkencës dhe funksionimin e institucioneve që mbartin këtë veprimtari në vendin tonë, theksoi deputeti Ismet Beqiraj.

Relatori i kushtoi një vend të veçantë rolit të Akademisë së Shkencave për konsolidimin e gjuhës shqipe, krahas Akademisë së Studimeve Albanologjike, institucioneve të arsimit të lartë e të kërkimit shkencor etj., që është një nga detyrat kryesore për mbrojtjen e identitetit kombëtar.

Në lidhje me pikën 7, të nenit 4, për rolin dhe funksionet kryesore të Akademisë, ku në arsyetimin e dekretit të Presidentit, thuhet: “nuk është në harmoni me parashikimet e ligjit 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, deputeti theksoi se përfaqësuesit e MASR kanë qenë “rojtaret më të rreptë” për të mos pasur mbivendosje gjatë diskutimit, tërheqjes së mendimit, kalimit nen për nen e deri në miratimin në seancën plenare në Kuvend.

Relatori u ndal edhe në çështje të tjera që lidhen me rolin e Akademisë së Shkencave në fushën e kërkimit shkencor, hartimin e raporteve në bashkëpunim me institucionet e tjera etj..

Z. Erzen Tola, drejtor i Përgjithshëm në Drejtorinë e Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit në Kuadrin Rregullator në MASR, theksoi se MASR i mbetet opinionit të Këshillit të Ministrave.

Akademiku Vaso Tole u ndal në mënyrë të përmbledhur në lidhje me çështjet e shprehura të dekretit të Presidentit të Republikës, për kthimin për rishikim e përmirësim të neneve dhe pikave përkatëse, duke i kundërshtuar ato sipas argumenteve të poshtëshënuar.

Zoti Tole që në fillim theksoi se të gjitha çështjet janë të diskutuara dhe u janë dhënë zgjidhje;

Akademia koordinon, bashkëpunon, këshillon, jep ekspertizë etj.. Nuk ka uzurpim, as shkelje kompetencash të institucioneve të arsimit të lartë. Ne kemi një mision të përbashkët dhe secili bën punën e vet. Thelbi i këtij ligji është hapja e akademisë për të tjerët.

Kontestohet pika 1/3. Ne flasim për hierarki vlerash. Në hierarkinë e titujve, titulli "Akademik" qëndron mbi titullin "Profesor". Pra, është titulli më i lartë.

Pika 3/4, ku flitet për ndërtim strategjik, zbatim politikash, askund urdhërim, për përdorimin e njësuar të gjuhës shqipe zyrtare, nuk është një detyrë e re. Këtë rol e funksion e kryen çdo akademi simotër në Europë dhe Akademia e Shkencave është përpjekur ta kryejë ndër vite nëpërmjet punës së përbashkët me ASHAK-un, edhe në bazë të ligjeve të mëparshme.

Kongresin e Drejtëshkrimit të Gjuhës Shqipe e ka organizuar Akademia e Shkencave, por nuk ka monopolin e gjuhës, ne jemi garant të saj për të sensibilizuar nevojat që ka gjuha dhe kujdesi ndaj saj.

Pika 7, 14/4. Këto pika, ashtu si tërë pikat e nenit 4, specifikojnë disa nga drejtimet kryesore të rolit të ASH-së. Siç dihet, Asambleja e ASH-së, si një organ këshillimor e promovues i shkencës e kërkimit shkencor, ka për detyrë të nxisë e të vlerësojë nivelin e kërkimit në tërësi dhe jo vetëm në IAL.

Raportet e rekomandimet kanë gjithnjë një rol ndihmues dhe nuk cenojnë kurrë autonominë e lirinë akademike në vendimmarrje. Pra, këto pika janë në harmoni me ligjin 80/2015.

Pika 3/6. Kjo pikë nuk bën asnjë lloj diskriminimi. Akademitë e shkencave në Europë kanë pothuaj të njëjtat standarde. Gjithë akademitë europiane, si anëtarë të jashtëm e korrespondentë, zgjedhin ndër kontribuesit më të mirë të shtetësisë a kombësisë përkatëse. Anëtarët e nderit zgjidhen pa lidhje origjine e shtetësie, por aktiviteti i tyre duhet të ketë lidhje me vendin përkatës.

Për sa i takon shqetësimit se pranimet bëhen pa pëlqimin e personit, kjo nuk qëndron, pasi procedura e pranimit do të përcaktohet qartë në statut.

Pika 1/15. Diskriminimet moshore pranohen, kur ato bëhen për shkaqe të arsyeshme. Një e tillë është dhe dalja në pension

Kufizimi i vendosur lidhet pikërisht me moshën e daljes në pension për personat që kanë titullin "Profesor". Kjo argumentohet me faktin se një individ që fiton titullin "Akademik" duhet të ketë një kohë veprimtarie aktive minimale si shkencëtar e kërkues shkencor, pas marrjes së titullit "Akademik" dhe se gjatë aktivitetit të tij 30-40 vjeçar, në rast se plotëson kriteret e fitimit të titullit, ai i ka tërë mundësitë për anëtarësim, pa e arritur këtë moshë. Kufizime të tilla ka edhe në përvoja të tjera, për të siguruar një pjesë aktive të anëtarësisë së Asamblesë.

Pika 1/19. Kjo pikë nuk cenon aspak ligjin 80/2015, pasi fakti që ky ligj tregon se si ngrihen institucionet kërkimore pranë IAL-eve, nuk do të thotë aspak se këto institucione ngrihen vetëm sipas atij ligji. Ligji për Shkencën tregon dhe se si ngrihen institucionet kërkimore pranë e jashtë IAL-eve, ndërsa ligji 53/2019 tregon se si ngrihen ato pranë ASH-së.

Pikat 5, 6, neni 11. Tërë argumentimet e përdorura në arsyetimin e dekretit për të provuar mospërputhjen e këtyre pikave me Kushtetutën janë rezultat i një "interpretimi" të keq të nenit 92/g të Kushtetutës dhe të ligjit të ASH-së në fuqi.

Gjithë sa më sipër nuk qëndron në rastin e ligjit të ASH-së, pasi neni 92/g i Kushtetutës thotë:

“Presidenti i Republikës emëron kryetarin e ASH-së dhe rektorët e universiteteve sipas ligjit”, ndërsa neni 94 i saj thotë: “Presidenti nuk mund të ushtrojë kompetenca të tjera, përveç atyre që i njihen shprehimisht në Kushtetutë dhe që i jepen me ligje të nxjerra në pajtim me të.”. Këtej del qartë se vetë Kushtetuta "autorizon" ligjin e ASH-së (në rastin tonë) dhe ligjin 80/2015, të përcaktojnë se cili është në fakt roli i Presidentit në emërimin e kryetarit të ASH-së ose të rektorëve të universiteteve.

Për pasojë, ligji i ASH-së ka të drejtën kushtetuese të parashikojë edhe mënyrën e zhbllokimit në rast bllokimi, pa qenë nevoja për “ndryshime kushtetuese”.

Nuk njihet asnjë praktikë, kur, pasi në legjislacion konstatohet një rast bllokimi, ligjvënësi të mos ndërhyjë për të përmirësuar dispozitat ligjore. Pikërisht këtë bën ligji i ri.

Emërimi i titullarëve të tyre, të zgjedhur prej trupës akademike përkatëse, nga Presidenti i Republikës është qartazi një kompetencë honorifike që i jepet Presidentit, të cilën ai duhet ta ushtrojë sipas ligjit përkatës (neni 92/g) etj..

Në mbledhjen e Komisionit diskutuan për çështje të dekretit deputetët Vilma Bello, Fadil Nasufi, Fidel Ylli, Bujar Çela.

Znj. Fatjona Dhimitri, kryetare e Komisionit, gjatë seancës së diskutimit të dekretit të Presidentit të Republikës u shpreh kundër ligjit të miratuar dhe mbështeti dekretin.

V.PËRFUNDIM

Në përfundim, Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik, me shumicën e votave të deputetëve të pranishëm u shpreh kundër dekretit të Presidentit të Republikës Sh.T.Z. Ilir Meta, me nr.11256, datë 08.08.2019, “Për kthimin për rishqyrtim në Kuvend, të ligjit nr.53/2019,“Për Akademinë e Shkencave të Republikës së Shqipërisë”, dhe i paraqet seancës plenare miratimin e këtij raporti.

RELATORI

Ismet BEQIRAJ

ZV/KRYETARE

Milva EKONOMI